

---

---

## REFERATE E KUMTESA

---

---

LUAN MALLTEZI

### SKËNDERBEU DHE RILINDJA KOMBËTARE\*

Shprehja e njohur se “kombet nuk ndahen dot në historinë e tyre nga mitet dhe heronjtë e vet”<sup>1</sup> ka vlerë të përjetshme për figura të shquara historike si Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468). Nën udhëheqjen e tij, shqiptarët kaluan një nga periudhat më të rënda të historisë së tyre. Ata u përballën me sukses për 25 vjet me radhë me fuqinë më të madhe ushtarake të kohës, siç ishte Perandoria Osmane në shek.XV, që tentonte të pushtonte vendin. Kalorësi anglez Njuport, që kishte njohur nga afër në Shqipëri stuhinë e tmerrshme të kohës, shprehej, se invazioni i Evropës ishte i sigurtë po të binte kështjella arbëreshe.<sup>2</sup> Si figurë, që lindi në këtë mjedis të ashpër ku luftohej për jetë e vdekje për mbrojtjen e vendit, Skënderbeu do të ngulitej thellë në ndërgjegjen e shqiptarëve, si një luftëtar i madh e i pathyeshëm.

“Fytyra e Kastriotit - shkruante Barleti në veprën e tij të njohur “Historia e Skënderbeut”- ishte ngulitur aq fort në mendjen e secilit dhe emri e mbretëria e tij ishte skalitur aq thellë në gjokset e të gjithëve, sa që do të ishte më lehtë, siç thonë, t’i shkulje Herkulit topuzin nga duart, se sa të fshije nga zemrat e zjarrta të vegjëlisë dashamirësinë dhe dashurinë për Skënderbenë”<sup>3</sup>.

Humanisti i njohur italian *Antonius Sabellicus* (1436-1506), tregon se pas vdekjes së tij, populli e kujtonte prijësin e paharruar me këngë solemne. “Më kanë treguar burra të denjë për t’u besuar se mu në mes të zjarrit të luftës, kur gjithshka shungullonte nga armët e barbarëve, grumbuj vajzash e kishin zakon të mblidheshin javë për javë në sheshe të qyteteve, ku ai kish sunduar

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Kombëtare “Shqiptarët përballë sfidave të bashkimit dhe të lirisë”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 13 qershor 2008.

<sup>1</sup> S. Metais, *Histori e shqiptarëve*, Tiranë: 2005, f. 65.

<sup>2</sup> *Historia e Shqipërisë*, I, Tiranë: 1959, f. 300.

<sup>3</sup> Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, (përkthyer nga S.Prifti), Tiranë: 1964, f.113, 169, 255.

dhe këndonin lavditë e princit të tyre të vdekur”<sup>4</sup>. Të dhëna të tilla japin edhe klerikët shqiptarë të shek.XVII.

Marin Bizzi, arkipeshkv i Tivarit, në relacionin e tij të vitit 1610 drejtuar Palit V lidhur (pas vizitës së tij baritore në dioçezat e Shqipërisë dhe të Serbisë), njofton se luftimet e tij kundër turqve ishin nxjerrë në vargje dhe “këndoheshin prej të gjithë shqiptarëve dhe në praninë e turqve”<sup>5</sup>.

Pjetër Budi në relacionin e tij të vitit 1621 njoftonte për një kryengritje antiosmane, që kishte shpërthyer në disa krahina, që njiheshin në popull me emrin e “Viset e Skënderbeut”<sup>6</sup>.

Frang Bardhi, peshkopi i Sapes, në relacionin drejtuar në Romë mbas vizitës së tij në rrethin e Pukës, më 1637, shkruante se “(shqiptarët) ndër gostitë e tyre, nëpër rrugë e nëpër punë, këndojnë me zë të lartë trimëritë e burrave të tyre të mëdhenj, dhe sidomos të të paepurit zotit Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbe, dhe të të shkëlqyeshmit zotit Lekë Dukagjinit”<sup>7</sup>.

Më gjerë për Skënderbeun shkruan Frang Bardhi në veprën kushtuar origjinës shqiptare të tij:<sup>8</sup>

“Deri më sot tanët flasin pa pushim vetëm për të dhe në sofra këndojnë me zë të lartë punët e tij. Ata e quajnë me emën të posaçëm për antonomazi, Skënderbeun tonë Kuçedra e Arbnit d.m.th. Dragoi i Epirit. Kur shqiptojnë këto fjalë ata kuptojnë vetën atë, Skënderbeun”<sup>9</sup>. Më 1671 udhëtari osman Evlia Celebiu<sup>10</sup> shënon një lagje të Ohrit që mbante emrin e Skënderbeut<sup>11</sup>.

<sup>4</sup> Antonius Coccius Sabellicus, *Rerum Venetiarum*. Istorici delle Cose Veneziane, Vol.I, Venice, Louisa, 1718 (lxx); Fan S.Noli, *George Castrioti Scanderbeg (1405-1468)*, New-York: 1947, f. 150, nr.48.

<sup>5</sup> “Në kishën e sipërthënë thonë se ka qënë varrosë i famëshmi Aleksandër Kastrioti , i quajtur me emër tjetër Skanderbeg, i cili u da në shënj me shumë luftime të vlerata kundër turqve, të cilat të qituna në vargje, këndohen n’atë gjuhë prej të gjithë shqiptarëve, edhe në praninë e turqve”. Marino Bizzi, *Relazione dell’arcivescovo d’Antivari M.B. diretta al Papa Paolo V in merito alla visita da lui svolta nelle diocesi d’Albania e di Serbia, anno 1610. Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, Volumi I (1610-1634), Tiranë: 1963 (teksti origjinal dhe përkthimi përgatitur nga I.Zamputi), f. 86. (më tej: *Relacione*).

<sup>6</sup> *Lettera di Pietro Budi, vescovo di Sappa, diretta al cardinale Gozzadino in merito alla possibilita dell’organizzazione della guerra in Albania e nel resto dei Balcani. Roma 15 settembre 1621. Relacione*, f. 84.

<sup>7</sup> *Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë*, III, Tiranë: 1962, f.202.

<sup>8</sup> Georgius /Castriotus/ Epirensis vulgò Scanderbegh / Epirotarum princeps Fortissimvs, / ac inuictissimus Suis, & Patriae restitutus / Per Franciscum Blanchvm / De Alumnis, Colegij de Propaganda Fide / Episcopum Sappatensem / & Sardanensem, necnon Pulatensium aliorumque / Albaniae Populorum Administratorem. Venetijs, 1636, f.75.

<sup>9</sup> “Et vsque ad hodiernum diem assidue nostrates colloquantur de ipso, eiusque res gestas in çonuuiis alta voçe (ut diximus ) canunt, atque precipuo nomine, per

Në dokumentet historike të shek XVII, në relacionet që eksponentë të rëndësishëm shqiptarë i dërgonin mbretërisë së Spanjës për të ndërhyrë për çlirimin e Shqipërisë, përmendin Skënderbeun si një udhëheqës dhe luftëtar të madh shqiptar<sup>12</sup>.

Udhëshkruesi francez Ami Boué, në veprën e tij “La Turquie d’Europe”, botuar më 1840, vinte në dukje se “në veri, Hot, Shalë, këngët popullore kanë si hero Gjergj Kastriotin, kurse në jug këndohet akoma për luftrat e Aranit Golem Topisë, që ishte lidhur me Skënderbenë për të përzënë turqit nga Epiri”<sup>13</sup>.

Për kujtimin e Skenderbeut në popull, njofton edhe konsulli francez F.Pukvill (Pouqueville): “Këta djem të maleve të Çikës - shkruan ai, këngët e tyre që shtyhen në shekujt e Skënderbeut të lavdishëm, shefit të tyre i përdorin për të sharë dobësinë e osmanëve”<sup>14</sup>.

Albanologu i njohur austriak J.G.Hahn, shkruante në veprën e tij “Udhëtim nëpër viset e Drinit e Vardarit”, se në krahinën e Krujës dhe të Matit ekzistonin një tog legjendash për Skënderbeun, të cilat i krahasonte me sagat gjermane të mbretit të Gotëve, Theodorikut. M.Hatry, shkruante më 1808, se “në Lezhë shqiptarët nuk flasin kurrë pa veneracion për Skënderbeun, ata këndojnë edhe sot për nder të tij një këngë të vjetër”<sup>15</sup>. Të dhëna të tjera për Skënderbeun japin edhe autorë të tjerë.

Skënderbeu dhe epoka e tij mori rëndësi të veçantë gjatë periudhës së Rilindjes, e cila i kushtoi një vëmendje të veçantë temës së historisë kombëtare. Duke trajtuar këtë temë rilindasit tanë të mëdhenj synonin forcimin e

autonomasiam Scanderbegum nostrum, Culscedra e Arbenit, id est Draco Epiri appellans, quae voces, cum pronunciantur, ipse solus Scanderbegus intelligitur”. (*Poaty*).

<sup>10</sup> Evlia Çelebiu, *Shqipnia para dy shekujsh* (përkthyer nga Sali Vuçitëri), Tiranë: 1930, f.126.

<sup>11</sup> *Poaty*, f.126.

<sup>12</sup> *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë (1603-1621)*, III, (përgatitur nga I.Zamputi), dok. nr. 2, 9, 70, 167, 211, Tiranë: 1989.

<sup>13</sup> Ami Boué, *La Turquie d’Europe*, II, Paris: 1840, f.108; Q.Haxhihasani, “Të dhëna bibliografike”, *Studime Filologjike*, 4, Tiranë: 1967, f. 168; Anton Çeta, “Fytyra e Skënderbeut në traditën popullore”, *Simpozium*, f. 278-279.

<sup>14</sup> H.C.L.Pouqueville, *Vouage en Morée, à Constantinople, en Albanie et dans plusieurs autres parties de l’Empire Ottoman pendant les années 1798, 1799, 1800, et 1801*, III, kap. XXVII, Paris: 1805, f.288; Q Haxhihasani, *vep. e përm.*, f. 169; Sh.Pllana. “Skënderbeu në krijimtarinë gojore të Kosovës dhe të Maqedonisë”, *Simpozium*, f. 288.

<sup>14</sup> *Poezija popullore ...*

<sup>15</sup> Hatry M. Journal de voyage fait en Albanie et a Corfou pas ordre de S.A.I. Monsieur le Prince Viceroy d’Italie, par M.Hatry, capitaine aide de camp. 1-er Fevrier 1808.

ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve me traditat më të lavdishme të të kaluarës së tij historike. Me këto, ata përpiqeshin të hidhnin poshtë edhe shpifjet e shovinistëve fqinjë, që mohon ekzistencën e popullit shqiptar<sup>16</sup>. Shkrimet e kohës tregojnë, se rilindasit dhanë shembullin me të mirë të përdorimit të historisë, në shërbim të detyrave aktuale të kohës. Në veprat e tyre, ata trajtuan dy hallka të rëndësishme të historisë sonë : prejardhjen e lashtë të shqiptarëve në tokat e veta dhe epokën e Skënderbeut.

Rilindasit mbështetën tezën e albanologëve të kohës mbi origjinën pellazgjike të shqiptarëve. Me këtë, rilindasit gjenin një mbështetje të rëndësishme shkencore, për të treguar para opinionit të gjerë, se shqiptarët ishin një popull i vjetër i Ballkanit dhe autokton në truallin e tij. Me këtë, siç thonte V.Dorsa, rilindasit kërkonin të ringjallnin “para opinionit publik të drejtat e një kombi të lavdishëm por të panjohur”<sup>17</sup>. Kuptohet se në këtë vështrim rilindasit do t’i referoheshin po ashtu me shkrime të shumta edhe heroit të tyre legjendar Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

“Të gjithë sa jemi, shkruante “Liri e Shqipërisë”, duhet t’i shëmbëllemë atij burri me fletë, të bëhemi një trup e një shpirt dhe të punojmë e të luftojmë për lirinë dhe përparimin e Shqipërisë. Kështu nderojmë vetën tonë dhe Skënderbenë”<sup>18</sup>. Me figurën e Skënderbeut, rilindasit synonin të realizonin bashkimin kombëtar të shqiptarëve, të cilët Perandoria Osmane dhe Patrikana e Stambolli i kishin ndarë midis tyre në besime të ndryshme fetare, myslimanë dhe të krishtere katolikë e ortodoksë. Duke pasur parasysh këtë situatë, Çajupi shkruante vargjet e njohura se shqiptarët : “Kanë qenë trima të lëvdur / Dhe në luftë s’janë turpëruar / Qenë trima mëmëdhetarë/ Besa feja s’i kishin ndarë / Shkonin jetën me pushkë në dorë, / Lulëzonte gjithë Shqipëria”<sup>19</sup>.

<sup>16</sup> Aleks Buda, *Shkrime Historike*, II, Tiranë: 1986, f. 189.

<sup>17</sup> V.Dorsa, *Su gli albanesi, ricerche e pensieri*, Napoli: 1847, f.5.

<sup>18</sup> Fletorja *Liri e Shqipërisë*, Sofje: viti II, nr. 69, 18 mars 1912, f.1.

<sup>19</sup> Një nga autorët më të rëndësishëm, që i bëri thirrje shqiptarëve për tu bashkuar pavarësisht nga besimi i tyre, ishte Vaso Pasha. Në vitin 1879 ose 1800, ai botoi nxorri vjershën e shquar letrare, e cila doli edhe në formë trakti “Mori Shqypni, e mjera Shqypni”. Me një gjuhë popullore me plot figura poetike, poeti nis duke kënduar madhërinë e dikurshme të Shqipërisë dhe pastaj vijon me gjendjen e mjerueshme:

“Por si lis i naltë i rrxuem për dhe / Të shkon balta sipër, më kambë të shklet / E një fjalë t’ambël kurrkush s’ta flet”.

Shkakun e këtij mjerimi, poeti e shihte në përçarjen fetare e krahinore të Shqiptarëve. Autori në fund u drejtonte shqiptarëve kushtrimin e fuqishëm për bashkim kombëtar: “Çoniu, shqiptarë, prej gjumit, çoniu, / Të gjithë si vllazën më një besë shtrengoniu, /Edhe mos shikoni kisha e xhamia, /Feja e shqyptarit asht shqyptaria”

Vjersha mbaron me një thirrje të fuqishme për të rrokur armët dhe për të përtërirë periudhën e lavdishme të Skënderbeut, për ta bërë Shqipërinë përsëri një “zonjë të rëndë” midis vendeve të tjera.

Epoka e Skënderbeut paraqiste një shembull të shkëlqyer në bashkimin e shqiptarëve edhe për Naim Frashërin. “ Po të ini të bashkuar/ shkruante ai / është e bërë Shqipëria”<sup>20</sup>.

Duke kuptuar ndikimin e figurës së Skënderbeut në popull, Naimi i kushtoi atij edhe një vepër të veçantë të titulluar “Istori e Skënderbeut” (1899). Në këtë vepër Naimi shkruante :

“Skënderbeu është i gjallë / Rron e mbretëron për jetë / Kjo fjalë s’është përrallë / Ndaj t’urtit është e vërtetë”.

Vepra e Naimit bëri për vete mbarë shqiptarët; luftëtarët e parë për pavarësi e mbanin atë me krenari nën sjetull për ta lexuar deri në fund të qëndresës së tyre<sup>21</sup>.

Emri i Skënderbeut në shkrimet e rilindasve u bë flamur i luftës për liri dhe simbol i shtetit të pavarur shqiptar.

Në veprën e tij “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhetë” botuar në Bukuresht më 1899, Samiu e quante Shqipërinë e shek.XV “një mbretëri me një mbret trim e të zonë si Skënderbeu”<sup>22</sup>. Këtij burri - shkruante Samiu “istoria s’i tregon shok e shëmbëll në trimërit, në diturit të luftës, në forcët si dhe dijet, në mendimit të drejtë, në njerëzit, në ëmbësit të zëmrës e në madhëri të shpirtit”<sup>23</sup>. Samiu shkruante se në shtetin, që do të ndërtonin shqiptarët, ata do të përjetësonin edhe emrin e heroit, sepse kryeqyteti i këtij shteti të ri do të quhej sipas tij emrit të tij “Skënderbegas”<sup>24</sup>.

Më 1879, P.Vaso botoi shqip (me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit) veprën: “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”<sup>25</sup>. Vepra merrej kryesisht me origjinën pellazgjike të shqiptarëve por autori trajtonte aty edhe historinë e

<sup>20</sup> Naim Frashëri, *Histori e Skënderbeut*, Tiranë: 1953, f. 341.

<sup>21</sup> Rexhep Qosja, “Skënderbeu në vizioni e Naim Frashërit”, *Simpozium për Skënderbeun - Simpozijum o Skënderbegu (9-12 maj 1968)*, Prishtinë: 1969, f. 337.

<sup>22</sup> Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhetë?*, Bukuresht: 1899, f. 12.

<sup>23</sup> *Po aty*.

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 69.

<sup>25</sup> P.Vassa, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët* (Përkthyer dhe botuar shqip nga Mehdi Frashëri,) Tiranë: 1935. Vepra u botua po në atë vit, në një përkthim më të zgjeruar frëngjisht dhe gjermanisht. Më 1880 u botua turqisht dhe greqisht. Në këtë libër autori dëshironte “tu kujtonte popujve të qytetëruar këtë popull të harruar (shqiptar), të mbronte kundër keqdashjes këtë popull që e kishin sharë, i bënte drejtësi këtij populli, kundër të cilit kishin grumbulluar shpifje”. P.Vaso, mendonte se në shekujt e parë të pushtimit turk, populli shqiptar duhej konsideruar më tepër si “aleat”, se sa i nënshtruar i osmanëve, për arsye të privilegjeve që kishte gëzuar, por autori nuk shihte, se këto privilegje i kishin pasur vetëm disa feudalë si shpërblim për shërbimet e bëra Portës dhe jo i gjithë populli. Kthesa vendimtare për keqësimin e gjendjes së popullit shqiptar sipas tij niste më 1831, me rrëzimin e feudalëve të mëdhenj të pavarur shqiptarë.

Skënderbeut, i cili kishte rrëmbyer armët kundër turqve osmanë për të mbrojtur pavarësinë vendit.<sup>26</sup>

Hovi që mori Lëvizja Kombëtare në vitet 1876-1881 dhe veçanërisht në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, u shoqërua me një zhvillim të rëndësishëm të letërsisë artistike dhe lëvizjes mendore shqiptare. Duke u lidhur me detyrat e mëdha politike të ditës, lëvizja mendore mori një frymëzim të zjarrtë patriotik e luftarak dhe letërsia shqiptare e këtyre viteve në disa raste u ngrit në një shkallë të lartë artistike. Vjershëtarë si: Spiro R.Dineja, Thimi Mitkoja, Pashko Vasa, Filip Shiroka etj., ia kushtuan krijimtarinë e tyre lirike luftës së popullit shqiptar. Poezia e këtyre viteve ishte një poezi e flaktë, që i ftonte shqiptarët të rrëmbenin armët për liri. Spiro R.Dineja, duke evokuar kohën e Skënderbeut, kërkonte që, mbi muret e Krujës të valonte përsëri flamuri i lirë shqiptar, përndryshe nuk kishte kuptim rrojtja e shqiptarëve<sup>27</sup>.

Zef Jubani (1818-1880), mbledhës i hershëm i folklorit të Shqipërisë së Veriut<sup>28</sup>, shkroi veprën “Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut”, por kjo nuk mundi të shihte dritën e botimit<sup>29</sup>. Po kështu, nuk pa dritë botimi edhe “Historia e Skënderbeut”, shkruar nga Thimi Kreji në Egjipt, më 1877<sup>30</sup>.

Shtypi i rilindjes luajti një rol të rëndësishëm për të bërë të njohur traditat liridashëse të popullit shqiptar. Ai ngriti lart traditën e luftës, që ndoqi Skënderbeu, duke u mbështetur në forcat e tij të brendshme.

Kur Shqipëria po vihej në rrezik nga vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit, revista “La Nazione Albanese” botoi një nga thirrjet e vitit 1878 të Lidhjes së Prizrenit, që kishte në qendër të saj figurën e fuqishme të Skënderbeut.

“Shqipëria - shkruante revista, ka një faqe të shkëlqyer në historinë e kombeve. Skënderbeu, Lekë Dukagjini, Marko Boçari etj., mishërojnë karakterin e popullit shqiptar. Si një trup i vetëm, shqiptarët bashkohen me

<sup>26</sup> “Gjergj Kastrioti i mbiquajtur Skënderbe prej turqve, pasi jetoi një kohë pranë Sulltanit, si peng, arriti të pushtojë Krujën, dhe të gjithë pronat e stërgjyshëve të tij, që i kishin pushtuar turqit. Në emrin e shqiptarëve edhe me ndihmën e tyre - shkruan Pashko Vasa - i shpalli luftë dy sulltanëve më të tmerrshëm të perandorisë otomane, Murati II, dhe të birit të tij Mehmetit. Në këtë kohë u lidh bashkimi shqiptar, kryetar i të cilit ishte Skënderbeu”. Pashko Vasa përmend edhe emrat e disa krerëve të tjerë shqiptarë të shek XV.

<sup>27</sup> Aleks Buda, *Shkrime Historike*, II, Tiranë: 1986, f.189.

<sup>28</sup> Idetë e tij i parashtrroi në dy studimet e tij “Gjendja aktuale e popullit të Shqipërisë së Veriut” dhe “Kundër mbi gjendjen morale dhe mbi kulturën intelektuale të popullit shqiptar”, që u botuan më 1871 si hyrje në një përmbledhje këngësh popullore.

<sup>29</sup> *Po aty*, f.55-56.

<sup>30</sup> *Po aty*, f.190.

entuziazëm rreth atij udhëheqësi, që do të ngrejë përsëri mbi malet e atdheut tonë shqiponjën e Skënderbeut”.

Flamuri i Skënderbeut u zgjodh nga rilindasit si flamur i luftës për liri.

“Në programin tonë - shkruante gazeta “Ili i Arbreshvet” më 1896 - vëmë si detyrë kryesore përpjekjet për bashkimin e të gjithë bijve të Shqipërisë e të themi : Nisu o pëllumb i bardhë, përshtko detin Jon, jep përshtendjet e ngrohta nënës Shqipëri dhe thuaji se bijtë e tu arbëreshë në Itali, të cilët flasin në gjuhën e të parëve tanë të kohës së Skënderbeut, shohin në horizont, në flamurin e vjetër, një yll të ndritur, është Ylli i arbëreshëve që do të sjellë ditë të mira për mëmëdhenë tonë Shqipëri”.

Shkrime të tilla për figurën e Skënderbeut u botuan në organet “Drita” e Shahin Kolonjës, “Kombi” i Sotir Peçit, “Shpnesa e Shqypnis” e Nikollë Ivanajt, “Shqypeja e Shqypnisë” e Josif Bagerit, “Korça” e Sami Pojanit, “Rrufeja” e Jani Vretos, “Kalendari Kombiar”, “Fiamuri i Arbërit” “Albania”, “Flamuri i Shqipërisë”, “Shqipëria”, “La Nazione Albanese” etj.

“Këtë epope të madhe - shkruante fletorja “Shqipëria”- populli shqiptar e bëri nën udhëheqjen e Skënderbeut, duke u mbështetur në forcat e brendëshme të vëndit, në fuqinë dhe dashurinë e madhe të popullit shqiptar për lirinë dhe atdheun e vet”<sup>31</sup>.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu - shkruante e përdyjavëshmjia arbëreshe “La Nazione Albanese”, ushqeu gjatë gjithë jetës së tij një urrejtje të madhe kundër barbarëve turq, dhe i luftoi ato heroikisht”<sup>32</sup>.

“Të shumtë ishin në numur armiqtë barabarë”- shkruante fletorja “Shqipëria” që u vërsulën kundër Skënderbeut por bijtë e Shqipërisë nën udhëheqjen e tij nuk i përfillën ato asnjëherë. Ata, porsì fajkoj suleshin në mes të tyre, duke ju sjellë vdekjen dhe shkatërrimin e plotë.<sup>33</sup>

“Befasia dhe guximi kundër armiqve të shumtë - shkruante gazeta La Nazione Albanese - e bëri Skënderbeun mjeshtër të pashoq të pusive, por mbi të gjitha baza e fitoreve të Skënderbeut mbi armiqtë ishin lidhjet e ngushta, që ai mbante me masat popullore, të këshilluarit e Skënderbeut me popullin dhe luftëtarët e tij para çdo betejë kundër armiqve”<sup>34</sup>.

Artikuj të tillë janë të shumtë në shtypin e kohës<sup>35</sup>. “Pa shihni sa të këqij janë turqit!-shkruante “Albania”. A nuk jemi ne shqiptarët, stërnipërit e

<sup>31</sup> Fletorja *Shqipëria*, Bukuresht: viti II, nr. 48, 15 gusht 1898, f.2.

<sup>32</sup> *La Nazione Albanese*, Palagio: viti II, 30 janar 1898, f.8.

<sup>33</sup> Fletorja *Shqipëria*, Bukuresht: viti I, nr. 8, 28 qershor 1897.

<sup>34</sup> *La Nazione Albanese*, viti II, nr. 17, 15 shtator 1898, f. 2.

<sup>35</sup> “Para se të ndeshë me Ballaban pashën S., pyeti plakun e fshatit Skurraj “Si më mëson ti, kur kishëm me i ra këtij tradhëtarit” “Unë tjetër mësim s’ mund të të ap, po në je gati bjeri n’atë pikë vapet, kur anmiqtë janë zdashë e të shprenda disa tue u -la nëpër lumin e Matit e disa tue pa andrra në gjumë dhe kështu do t’i grish të tanë”; (*Albania*):

Skënderbeut ? Ç'presim ne, pse rimë nën turqtë? Ne që gjithë bota na kanë për trima, ç'flëm dhe nuk zgjohemi të përzëmë halldupnë nga vendi ynë<sup>36</sup>.

Shtypi i rilindjes diskutoi probleme të rëndësishme të zhvillimeve diplomatike të kohës. “Disa zotërinj të huaj dhe të shquar na qortojnë, përse ne e shkëputim fatin e Shqipërisë nga ai i Greqisë, duke shkaktuar kështu dobësimin e të dy vendeve”. “Ata - përfundonte “Fiamuri Arbërit” -nuk kuptojnë se ekzistenca jonë e veçuar ashtu si në të kaluarën, bën që ne të vazhdojmë të ekzistojmë dhe se bashkimi do t'i jepte fund ekzistencës sonë”<sup>37</sup>.

Nga viti 1879 filloi të botohej në Athinë nga arbëreshi A.Kullurioti gazeta e përjavshme “I fonis Allvancias”<sup>38</sup>. Me divizën “E duam Shqipërinë një, të pandarë, dhe autonome”, gazeta i vuri vetes si detyrë, t'i bënte të njohur botës synimet e atdhetarëve shqiptarë dhe ta informonte atë drejt mbi ngjarjet e Shqipërisë. Gazeta botonte artikuj e vjersha të Th. Mitkos, të J.Vretos, të P.Vasës etj. A.Kullurioti godiste në gazetë politikën greke, e cila, bënte “zhurmë kundër shqiptarëve sikur këta të kishin ndërmend të pushtonin Atikën!”. Kullurioti shkruante se, shqiptarët “po fillojnë të zgjohen si komb” dhe grekët duhet të gëzoheshin për këtë, sepse do ta kishin atë një aleat të ardhshëm”. Gazeta vinte në dukje kontributin që kishin dhënë shqiptarët në udhëheqjen e Skënderbeut në mbrojtje të qytetërimit evropian nga rreziku i pushtimit osman.

“Që të gjithë shqiptarët - shkruante gazeta - janë dhe e quajnë veten vëllezër të çdo dogme e të çdo fisi që të jenë. Evropa dhe asnjë shtet tjetër nuk mund të injorojë aspak të drejtën e qenies së popullit shqiptar, i cili ka qenë i vetmi mbrojtës në perëndim kundër invazorëve osmanë dhe nuk e ka pakësuar aspak lavdinë e trimërive heroike të Gjergj Kastriot - Skënderbeut”<sup>39</sup>.Gazeta

---

“Lëshoni dritat, përhapni retë e zeza - që të vështrojnë stërnipët e Skënderbeut se zgjedhë e tyre u vjen nga fetë” (*Po aty*); “S’kam për të heshtur, s’kam me pushuar, sa për tu tretur nën këtë dhe, - shkruante “Albania”, duke iu drejtuar kujtimit të Skënderbeut - gjer mos të dëgjoj se je çliruar ti shumë i dashur dhe i bukur atdhe” (*Po aty*); “Atëhere kur në Europë, dhe në Ballkan shumë popuj dhe kombe ishin shtypur dhe të përçarë, në Shqipëri kishte me të vërtetë një bashkim shqiptar, udhëheqsi kryesor i të cilit ishte Skënderbeu.” (Fletorja *Kombi*); “Skënderbeu bëri edhe një punë të mirë. Ai pajtoi vëllezërit e popullit tonë, u shtiu atyre bashkimin dhe vëllazërimin midis tyre, se me këtë bashkim e vëllazërim të popullit, që ai mësoi dhe udhëhoqi, u bëri ballë sulmëve të jeniçerëve” (Fletorja *Dielli*); “Vetë Skënderbeu pati dy fetë, kristianizmin dhe islamizmin, por që së fundi, i shkundi që të dyja dhe punoi e luftoi për një të vërtetë, për lirinë e Shqipërisë. Kështu na duhet të bëjmë edhe ne stërnipërit e tij, të bashkohemi të gjithë për të punuar vetëm për Lirinë e Shqipërisë” (Fletorja *Liri e Shqipërisë*).

<sup>36</sup> *Albania* e Brukselit, viti I, nr. 3, 25 maj 1897, f.3.

<sup>37</sup> Revista *Fiamuri Arbërit*, Kozencë (Itali): viti III, nr.10, 20 shkurt 1886, f.1.

<sup>38</sup> Shqip: Zëri i Shqipërisë.

<sup>39</sup> Fletorja *I Foni tis Allvancias*, Athinë: viti I, nr.3, 13 tetor 1879, f.3.

vinte në dukje gjithashtu, kontributin e shqiptarëve në mbrojtje të qytetërimit evropian nga pushimi osman.

“Nuk po flas për ideale dhe ngjarje të paqëna, - shkruante fletorja “I Foni tis Allvancias”- por për luftëra dhe sakrifica të mëdha të dokumentuara historikisht që bënë shqiptarët me Skënderbeun në krye në mbrojtje të atdheut të tyre dhe të vetë Europës nga invazioni turk”<sup>40</sup>.

“Tani - shkruante gazeta “Shqipëria” shqiptarët kanë filluar t’i tregojnë Evropës se janë gati të luftojnë për lirinë dhe atdheun e tyre, mbasi ay është edhe sot, siç ishte qëmoti, trim e lirisdashës si në kohën e Skënderbeut”<sup>41</sup>.

Skënderbeu, i cili luante një rol të rëndësishëm në jetën politike të arbëreshëve të Italisë<sup>42</sup>, u trajtua edhe nga De Rada, për shkak të rrezikut të copëtimit të vendit, që synonin shtetet fqinjë. Me veprën e tij, De Rada, synonte të ndihmonte zgjidhjen e problemit të bashkimi dhe çlirimit kombëtar nga zgjedha otomane. Autori e bëri shek XV objekt të veprimtarisë së të tij të gjerë

<sup>40</sup> *Po aty*, viti I, nr. 14, 24 dhjetor 1897.

<sup>41</sup> Fletorja *Shqipëria*, Bukuresht: viti I, nr. 13, 2 gusht 1897, f.3.

<sup>42</sup> Figura e Skënderbeut u bë shëmbull frymëzimi në luftën e arbëreshëve në ngjarjet e vitit 1848 dhe 1860, në Itali. Në kohën kur banorët e Kalabrisë dhe Siçilisë, me të cilët ishin ngritur edhe shumë arbëreshë me armë në dorë kundër regjimit absolut të Ferdinandit II të Napolit, Jeronim de Rada në gazetën *L'albanese d'Italia*, shkruante: “Të ngrihemi si Skënderbeu për çlirimin e atdheut të të parëve tanë”. Në organe të shtypit të arbëreshëve të Italisë (*Fiamuri Arbërit*, *La Nazione Albanese*, *L'Albania letteraria*, *Ili i arbreshvet*, *Flamuri i Shqipërisë* etj.), vihen në dukje akte heroike të arbëreshëve gjatë luftës për bashkimin e Italisë. “Palaciotët me shokë të kolonive të tjera arëreshe kanë qënë të parët në luftë - shkruan Gavril Dara i Riu - në artikullin “Topografia e Palac Adrianos”, botuar në revistën *Fiamuri i Arbërit*, më 30 prill 1884. Më tepër se 300 burra ndoqën me besim të patundur rrugën pas Garibaldit. Edhe në “Piana dei Greci”, sikurse shkruan Xhuzepe Muzaka në revistën *Fiamuri Arbërit*, më 20 prill 1886, “bij të familjeve të njohura arbëreshe muarnë pjesë me trimëri dhe guxim të madh në ngjarjet e vitit 1860. Katër nga gjiria e Petës, gjiri e Skënderbeut, janë lavdëruar në rapsoditë arbëreshe”. Në luftë për liri e drejtësi janë ngritur edhe arbëreshët e Ururit. “Duke mos qënë në gjendje t’i paguanin kishës detyrimet e shumta në të holla, thuhet në një artikull, ata filluan të ndiqeshin nga qeveria. Por ata, ashtu sikurse prindërit e tyre të hershëm, kanë qënë gjithmonë me armë në dorë dhe gjithshka e siguronin me mundim dhe forcën e tyre, sepse brenda tyre qëndron zëmra e fortë arbëreshe që ruajti vendin kundër ndërhyrjeve të jashtme”. Shtypi arbëresh preku edhe ndikimin e figurës së Skënderbeut në kryengritjen për pavarësi greke (1821), ku u shquan shumë arbëreshë si: Boçari, Xhavella, Kondurioti, Bubulina etj. Në shtypin arbëresh, ata përmenden si pasues të akteve luftarake të Skënderbeut. Për rënien heroike të Marko Boçarit, komandantit të forcës së përbërë prej 300 shqiptarësh në luftën e vitit 1821, *Ili arbreshvet*, shkruante më 1896: “Marko Boçari na kujton taktikën luftarake të mbrojtjes së Leonidës në betejën e Termopilave e më pas të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në betejën e Krujës”.

letrare. Ai krijoi veprën “Skënderbeu i pafan”, në të cilën ka ruajtur mjaft tipare nga ato që i ka dhënë Barleti.

Epoka e Skënderbeut është pasqyruar po ashtu tek veprat “Katër histori të Shqipërisë”, “Këngët e Serafina Topias”, “Skënderbeu i pafan”, “Një pasyrë shtegëtimi njerzor”, dhe “Gjon Huniadi”, që u botua pas vdekjes së poetit në botim italisht. Figurën e Skënderbeut e trajtoi edhe Gavril Dara i Ri në veprën: “Kënga e Sprapsme e Balës”, ku autori paraqet ndërhyrjen e Skënderbeut në grindjen e Nikut me Palin, duke i dhënë peshë të veçantë autoritetit të tij. Bilota i kushton një këngë të veçantë dyluftimit të Skënderbeut me tartarin në poemën “Shpata e Skanderbekut ndë Dibrët poshtë”.

Skënderbeu u bë një figurë me fuqi të lartë frymëzuese edhe në periudhën e luftës për pavarësi. Çetat shqiptarë për liri kishin në këngën e tyre vargjet e njohura.

“O trima luftëtarë / O bijt e Skënderbeut / Kërkoni ju shqiptarë / lirinë e mëmëdheut”.

Kuvendi i Vlorës, i 28 nëntorit 1912 realizoi ëndrrën shekullore të popullit shqiptar, krijimin e shteti të pavarur Shqiptar. Në sallën e mbledhjen së Kuvendit Kombëtar të Vlorës, ishte e pranishme edhe figura e Skënderbeut legjendar.<sup>43</sup>

---

<sup>43</sup> “Del steres e jo limanit / Të shoq të zot e vatanit / Bijt e Ismail Qemalit / Të Skënderbe faqebardhit”.